

## REKOMANDIME POLITIKE

**Parlamenti:** ta avancoj Ligjin për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi p.sh. të përfshihet baza e "orientimit seksual" në Neni 3; të rritet funksioni i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi (KMD) për të miratuar vendime që do të jenë me ligj të detyrueshme; të qartësohet niveli i kompetencave dhe vartësia midis KMD dhe organet tjera me mandat për anti-diskriminim; të sigurohen burime të mjaftueshme për funksionimin e KAD-it.

**Komisioni për mbrojtje nga diskriminimi:** ti studioj përvojat e homologëve të saj ndërkombëtarë dhe evropian; të organizoj konsultime vjetore me përfaqësues të shoqërisë civile; të inicioj fushata promovuese kombëtare/lokale në bazë vjetore ose dy herë në vit; të vazhdon me kërkesën për profesionalizim dhe ndërtimin e kapaciteteve të përfshirë edhe resurset e domosdoshme për funksionimin e saj.

**Qeveria qendrore:** të iniciojë ndryshime të kornizës ligjore e cila do të mundësojë dokumentim të formave të ndryshme të diskriminimit; t i unifikojë dispozitat ekzistuese nacionale që kanë të bëjnë me veprime diskriminuese; të organizojë trajnime të specializuara për administratën; dhe të siguroj stimulime për pikat e përcaktuara lidhur me barazinë gjinore në çdo ministri me qëllim të marrjes së rolit më proaktiv në çështjet për anti-diskriminim.

**Komisioni i komunës për mundësi të barabarta:** ti rrisin kapacitetet e tyre vis-à-vis çështjeve që kanë të bëjnë me anti-diskriminimin dhe të marrin masa aktive promovuese për edukimin e bashkësisë lokale për mekanizmat mbrojtës.

**Sistemi gjyqësor:** ta përmirësoj modelin ekzistuese për regjistrimin e rasteve dhe ta pasurojnë gjithnjë njohurinë për përmbajtjet e legjislacionit evropian dhe nacional, mekanizmat për zbatim dhe praktikatat gjyqësore në sferën e anti-diskriminimit.

**Spektori privat dhe sindikatat:** të sigurojnë politika të qëndrueshme lidhur me resurset njerëzore dhe sisteme të brendshme të dukshme korporative për vetë-rregullim të cilat do të jenë në mundësi ti parandalojnë rastet e diskriminimit në vendin e punës; dhe të mundësojnë mbledhjen dhe dokumentimin e formave të ndryshme të diskriminimit në vendin e punës

**Shoqëria civile:** të tërheqin resurse tjera financiare; të gjenerojnë ekspertizë dhe të ndërtojnë partneritet të qëndrueshëm dhe të mbajnë regjistrim efikas të rasteve të diskriminimit në çdo bazë, ti prezantojnë të njëjtat tek KMD; të ofrojnë përkrahje juridike, psikologjike, sociale dhe të tjerë për re-integrimin e qytetarëve që kanë qenë të ndikuar nga veprime diskriminuese; dhe të marrin masa promovuese për edukimin e bashkësive lokale për mekanizmat mbrojtës.

**Qytetarët:** të informohen me legjislacionin dhe politikatat ekzistuese për anti-diskriminim me qëllim që të shmangen nga situata që mund të rezultojnë me viktimizimin e tyre, segregimin e tyre dhe pabarazinë e tyre.

**Mediat:** ti ndërtojnë kapacitetet e tyre në lidhje me prezantimin e rasteve ku paraqiten paragjykimet dhe ti komunikojnë veprimet diskriminuese.

**Donatorët:** ti përfshinë çështjet anti-diskriminuese në portfolion e tyre për financim dhe ta përkrahin rritjen e vetëdijes, ndërtimin e kapaciteteve dhe partneritetit dhe iniciativat për ndërlidhje të cilat do ta edukojnë shoqërinë dhe institucionet e saja në sferat e ndryshme politike, sociale dhe humane.



Këto rekomandime të politikave janë zhvilluar nga Qendra për Zhvillim Ekonomik (CED), Sofje dhe Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave (CRPM) Shkup në kuadër të projektit "Këmbim i praktikave më të mira të BE-së në fushën e anti-diskriminimit të zbatimit të legjislacionit" (janar 2012 - janar 2013). Për më shumë informata, ju lutem referojuni në: [www.ced.bg](http://www.ced.bg), [www.crpm.org.mk](http://www.crpm.org.mk) Ky publikim është i hartuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e publikimit është përgjegjësi vetëm e QZHE/QHKP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të shihet si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.



Qendar Për Zhvillim Ekonomik  
46, Chervena Stena Rr., 1421 Sofia  
[www.ced.bg](http://www.ced.bg); [ced@ced.bg](mailto:ced@ced.bg)



Qendra Për Hulumtim Dhe Krijim Të Politikave  
6-2/9, Cico Popovic Rr., 1000 Skopje  
[www.crpm.org.mk](http://www.crpm.org.mk); [crpm@crpm.org.mk](mailto:crpm@crpm.org.mk)